



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 34  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302  
Prishtinë, më 29 janar 2019, në orën 13:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Enver Hoti, Drita Millaku, Haxhi Avdyli, Time Kadrijaj, dhe Naser Rugova.

**Munguan:** Miljana Nikoliq, Fikrim Damnka.

**Pjesëmarrës tjerë:** Ekonomia Online.

**Mbledhjen e kryesoi,** Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

**RENDI I DITËS:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për vitin 2019;**
- 3. Formimi i grupit punues për amendamentimin e Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

- 2. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për vitin 2019;**

**Besa Baftiu, kryetare,** tha se paraprakisht ishim në një takim, ku shumica e anëtarëve të Komisionit ishin prezent. Diskutuam sa i përket draftit të planit të punës së Komisionit për vitin 2019, ku pjesëmarrës ishin edhe partnerët tanë, ku gjithashtu edhe për këtë vit shprehen gatishmërinë që të bashkëpunojmë me Komisionin, duke pasur parasysh që pjesa më e madhe

projektiligjeve që i kemi në planin e punës, partnerët të cilët na mbështesin, kanë punuar në këtë drejtim.

Komisioni pas diskutimeve dhe rekomandimeve nga anëtarët e Komisionit, për shqyrtimin e draftit të punës të Komisionit për vitin 2019 nxori këtë:

## V e n d i m

Miratohet plani i punës së Komisionit për vitin 2019.

**Kryetarja**, kërkoi që të shikohet Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë, duke marrë parasysh, sa shkelen të drejtat e punëtorëve dhe tha se kemi nevojë ta monitorojmë këtë Ligj.

**Flora Brovina**, tha se në lidhje me programin e punës, të kontaktohet Kryeministri, MF-ja, MFSK-ja, MPB-ja, që të fillojë zbatimin e Ligjit të Emergjencave sepse pa këtë Ligj nuk do kemi ndryshime radikale në mbrojtjen e njerëzve. Vdekshmëria në punë është kaq e lartë pikërisht për shkak të mungesës së këtij Ligji për Emergjencë.

**Fatmire Kollçaku**, tha se e mbështes propozimin për monitorimin e Ligjit për Emergjencë sepse sipas informatave që kam, në QKUK, ende është problem mungesa e shtretërve, dhe se stafi po pret të vdes dikush që të kenë një shtrat të lirë për pacientet e tjerë.

**Haxhi Avdyli**, theksoi se Ligji për Duhanin nuk është fare duke u zbatuar dhe kërkoi që Komisioni të shikojë se ku ka ngecur sepse ky Ligj ka qenë shumë i mirë dhe se çfarë ndodhi me të, nuk e kuptoj se si Kosova hoqi dorë nga zbatimin e këtij Ligji. Sot vazhdon pirja e duhanit në mënyrë eklatante nëpër vende publike, duke filluar edhe nga vet Ministrinë.

**Flora Brovina**, tha se Komisioni në mandatin e kaluar ka bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit dhe ka nxjerrë konkluzione. Unë propozoj që Komisioni të analizojë këto konkluzione, se sa po zbatohen dhe pastaj nëse ka diçka për të shtuar ose ndryshuar, pastaj mund ta formojmë edhe grupin. Por kryesorja është ta shohim, se ku ka ngelur zbatimin e konkluzioneve sepse ato janë votuar nga Kuvendi.

**Bekim Haxhiu**, tha se ne si komision për monitorimin e zbatimit të Ligjit, pas monitorimit, duhet që ta bëjmë një raport në mënyrë zyrtare për këtë punë.

**Time Kadrijaj**, tha se ne mbledhjen e ardhshme të Komisionit unë po propozoj që stafi të sjellë rekomandimet e monitorimit të Ligjit për Duhanin, të shohim shkeljet që janë bërë. Është një raport i detajuar, dhe ta shohim atë dhe në takimin e radhës, kur ta kemi ministrin në raportim, të raportojë se çfarë po ndodh më këto rekomandime, kur e dimë që rekomandimet janë obligative sepse janë votuar në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

**Fatmire Kollçaku**- tha se si shembull i parë që është dashur të zbatohet Ligji, është dashur të jetë vendi ku dhe është miratuar ky Ligj, pra Kuvendi i Kosovës. Fillimisht duhet ta shohim ku shkelet Ligji sepse kjo do ishte hipokrizi ndaj qytetarëve. Nëse shohim televizionin publik aty vazhdimisht promovohet duhani dhe se nuk ka ndonjë reagim nga inspektorati.

**Kryetarja**, tha se unë pajtohem me atë që e tha deputetja Time dhe Fatmire. Tani që ne fillimisht të kemi rekomandimet që kanë dalë nga monitorimi, sepse nuk e dimë se sa janë zbatuar ato

rekomandime, e pastaj i diskutojmë dhe shohim se çfarë të adresojmë tek ministri. Nëse ka nevojë, prapë do ta monitorojmë.

**Bekim Haxhiu**, tha se ajo çfarë kanë ofruar në planin legjislativ këto dy Ministri, nuk i përmbush objektivat as te skemat pensionale, e as në Ligjet, të cilat na rregullojnë fushat në të cilat ne i mbulojmë. Krejt në fund të vitit 2019, pritet të jetë në shqyrtim Ligji për Shëndetësi, por pa plotësim ndryshim, Ligji për Sigurime Shëndetësore, edhe plotësim ndryshimi i Ligjit për Profesionistët Shëndetësorë, duhet të jetë, sepse e kanë kërkuar. Pakoja ligjore për shëndetësi dhe pakoja ligjore për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, do duhej të vinin të paktën në gjashtëmuorin e parë, në mënyrë që ne të arrijmë ti përmbushim deri në vitin 2019, që ato të planifikohen, pastaj për zbatim për vitin 2020, nëse nuk e kemi as Ligjin për Sigurime Shëndetësore brenda 2019, atëherë sigurisht zbatimi i tyre do të shtyhet edhe për një vit, deri më 2021 dhe kjo është shumë shqetësuese për të gjithë ne.

**Kryetarja**, tha se ne i kemi diskutuar edhe në mbledhjen paraprake të Komisionit, kanë qenë po thuajse shqetësimet e të gjithë anëtarëve të Komisionit, këto që ju i thatë tani. Ne si Komision këtë draft plan të punës e kemi hartuar konform strategjisë legjislative që e ka sjellë Qeveria, prandaj e dini është rregull i Kuvendit, rregull i Komisionit, që të punojmë në këtë mënyrë. Unë po besoj që sado që është i varfër, ne mund të bëjmë punë si Komision, monitorime të Ligjeve, takime, vizita të institucioneve të ndryshme të cilat bashkërisht e plotësojnë edhe bashkërisht vendosim, se cilat institucione ti vizitojmë, siç e kemi bërë vitin e kaluar.

**Bekim Haxhiu**, kërkoi që pjesë e planit të punës të jetë edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Pensionistët Kontributdhënës, pasi ju kemi premtuar si Komision. Ligj është diskriminues për një pjesë të kategorisë së shoqërisë sonë. Pasi Ministria nuk e ka planifikuar këtë Ligj në agjendën legjislative, që ne si Komision ta marri nismën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji dhe kjo të parashihet në planin e punës.

**Komisioni**, diskutoi në lidhje me monitorimin e zbatimit të ligjit, dhe pas diskutimeve nxori këtë:

### Vendim

**Formimi i grupit punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë.**

**Anëtarët e grupit punues:**

Besa Baftiu, kryesuese e grupit  
Flora Brovina, anëtare  
Naser Rugova, anëtar  
Time Kadrijaj, anëtare  
Fatmire Kollçaku, anëtare

**Naser Rugova** tha se, ne jemi duke vazhduar me monitorimin e zbatimit të ligjit për pajisje dhe produkte medicinale. Kemi bërë disa vizita dhe disa takime edhe në Ministri dhe tek Agjencia për Pajisje dhe Produkte Medicinale. Në këtë rast do të intensifikojmë që ti bëjmë edhe dy ose tri vizita në kryeqytet në disa barnatore të frekuentuara, pse jo edhe një vizitë në barnatoren Qendrore pra një institucion shtetëror, thjeshtë me e pa trendin, fluksin, banderolat edhe atë

rrjedhën e qarkullimit të medikamenteve konform kësaj agjende atëherë që mbrenda muajit shkurt ta përmbyllim raportin dhe ta njoftojmë zyrtarisht Komisionin.

### **3. Formimi i grupit punues për amendamentimin e Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social;**

**Kryetarja**- atëherë po kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës formimi i grupit punues për amendamentimin e Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social. Po besoj që keni qenë gjithë prezent dhe e dimë që ky Projektligj ka kaluar në lexim të parë në Kuvend. Edhe këtë Ligj e kemi monitoruar në legjislacionin e kaluar. I kemi rekomandimet, të cilat kanë kaluar në Kuvend dhe në bazë të këtyre rekomandimeve, të takimeve dhe dëgjimeve publike, nëse është e nevojshme do ta amendantojmë këtë Projektligj. Besoj që nuk do t' na marrë shumë kohë.

**Komisioni**, pas diskutimit nxori këtë:

#### **Vendim**

**Formohet grupi punues për amendamentimin e Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-008, për Këshillin Ekonomiko-Social.**

**Anëtarët e grupit punues:**

Enver Hoti, kryesues  
Drita Millaku, anëtare  
Besa Baftiu, anëtare  
Haxhi Avyli, anëtar  
Time Kadrijaj, anëtare  
Flora Brovina, anëtare

**Flora Brovina**- tha se monitorimi i këtij Ligji është shumë i rëndësishëm sepse pikërisht mosfunksionimi i duhur i këtij këshilli, janë probleme që po rrjedhin me protesta, me zbatimin e Ligjit të Grevës të organizimit sindikal, me bizneset dhe të tre faktorët nuk janë njësoj në rangun e ngritjes së tyre të njohjes së problemit. Ndoshta nuk i njohin të drejtat dhe obligimet ndaj njërit-tjetrit dhe qasja në zbatimin e këtij Ligji duhet me qenë shumë serioze..

### **4. Të ndryshme.**

**Naser Rugova**, tha se duhet të shqyrtojmë mundësinë te partnerët e Komisionit, që të angazhojmë staf shtesë, ekspertë të fushave. Komisioni Parlamentar për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, konsideroj që i monitorojmë dy dikastere, mbase më të rëndësishme në vend. Si Komision me një koncept unik edhe në raport me kirurgët edhe në raport me dikasteret tjerë. Ky Komision, tash një vit e gjysmë, nuk e ka bërë asnjë vizitë jashtë shtetit. Duhet të shikohet edhe ajo agjendë, në veçanti në sektorin e mbrojtjes dhe sigurimeve shëndetësore.

**Kryetarja**, u pajtua me propozimin e Naser Rugovës dhe kërkoi angazhim në këtë drejtim. Kushdo që mundet të gjejë një bashkëpunëtor e që e ndihmon Komisionin, është i mirëseardhur.

**Fatmire Kollçaku**, tha se ne e dimë që tashmë dy Qeveritë kanë takime të rregullta dhe unë mendoj që duhet me qenë një praktikë, që Kuvendi i Republikës së Kosovës, me atë të Shqipërisë

të kenë agjendë të përbashkët, qoftë takime një vjetore, apo dy herë në vit, sepse rrethanat ku jetojmë janë të ngjashme. Mendoj që ne si Komision, të insistojmë pikërisht tek Kryesia e Kuvendit. Kërkoj financim nga Kuvendi, e jo nga donatorët.

**Enver Hoti**, tha se propozimet janë shumë interesante, që të bashkëpunojmë me shtetet që janë në regjion dhe të marrim përvojat e tyre. Unë ndihem mirë që Qeveria ka hapur një bashkëpunim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë dhe është një ide e mirë që edhe Kuvendi ta bëjë një gjë të tillë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**